



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës / Republika Kosova  
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative  
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove  
01 Nr./Br. 413/p1-34998  
Data/Datum 17.11.2021  
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

I lidhur me datë: 16.11.2021, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;
2. OJQ “ART Urban”, të cilën e përfaqëson Arianit Hoti, në tekstin vijues “ART Urban”;

**Neni 1  
Qëllimi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim organizimin e festivalit “Artmania” në Komunën e Gjakovës, ku i njëjti festival do të jetë tradicional dhe do të mbahet në muajin Nëntor të çdo viti.

**Neni 2  
Obligimet e Komunës**

- 2.1 Komuna e Gjakovës do të siguroj mjetet financiare në vlerë prej 4,800.00 euro për realizimin e festivalit “Artmania” të organizuar nga OJQ “ART Urban”, sipas kërkesës së datës 11.11.2021.
- 2.2 Mjetet që do të ndahen për organizimin e festivalit “Artmania” do të ekzekutohen pas pranimi të faturave dhe arsyeshmërive të shpenzimeve të cilat do të jenë të argumentuara nga OJQ “ART Urban”, .
- 2.3. Mjetet në vlerë prej 4,800.00 euro do të ndahen nga kategoria mallra dhe shërbime, në të gjitha kategoritë e lira.

**Neni 3  
Obligimet e “ART Urban”,**

- 3.1 Obligohet të sjellë faturat, origjinale, arsyeshmëritë e shpenzimeve përmes së cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra, lidhur me aktivitetin e saj.
- 3.2 Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me llogarinë bankare.



**Neni 4**  
**Realizimi i festivalit "Artmania"**

4.1 Realizimi i plan-projektit për festivalin "Artmania" që do të bëhet gjatë muajit Nëntor 2021, me qëllim që behet festival tradicional.

**Neni 5**

5.1 Ky memorandum i bashkëpunimit është i përpiluar në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilave nga dy ekzemplarë u dorëzohen palëve kontraktuese.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë në përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

**PALËT**

**Komuna e Gjakovës**

  
**Ardian Gjini**



**"OJQ ART Urban"**



**Arianit Hoti**

